



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dymbëdhjetë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **27.02.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 26. <u>Melis Smakic, GIBL.</u> |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: “shembulli 1”)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: “shembulli 2”).

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: <https://>: “shembulli 3”).

Mbledhjen e hapur dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes njëzet e pesë (26) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Istogut,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023 -2027.
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2022,
6. Pyetje nga anëtarët.

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi.

Nënkryetari i Komunës - përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që në rend dite të hy si pik Formimi i komisionit për themelimin e këshillave të fshatrave.

Drejtori i Administratës z. Arben Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Formimi i komisionit për themelimin e këshillave të fshatrave.

Kryesuesi i Kuvendit – hedhe në votim, piken e rendit të ditës
Miratohet unanim nga anëtarët e kuvendit,

Pasi që nuk ka tjera propozime

Hedh në votim rendin e ditës

Miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje unanim nga anëtarët e Kuvendit.

Konstatojmë që me 26 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhje mungojnë z. Qerim Rexhaj, për shkaqe shëndetësorë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit - Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Florin Dreshaj - Përsëndetje për të gjithë, po me doket që ka nis me u bë e tepërt proverbialë po na vjen i mangët aty ku kemi folur për piken e rendin të ditës që e pate propozuar këshilltari Niman Beqiraj unë kam kërkuar që të hidhet në votim por ai fjalim mungon krejt jo vetëm, të unë por edhe të Agron Gashi edhe ai ka diskutuar për këtë çështje edhe mungojnë krejt fjalimet, kisha kërkuar që ky procesverbal që të mos votohet por të silltet në mbledhjen tjetër të kompletuar, dhe të këtë përmbajte dhe të mos hiqet komplet ju faleminderit.

Kryesuesi- Është akuze e rëndë që po e thua Florim incizimet në fillim unë kam pyetur sekretariatën pse joni kështu dhe i kam pa, po ashtu edhe i lexoj procesverbalet me vëmendje, edhe me kanë thënë që kanë pasur probleme në fillim pikërisht edhe Agronin edhe për ty, edhe për dikun tjetër kush ka diskutuar qatë periudhë që ka pas problem me incizim edhe nuk ju kemi përfshirë.

Florin Dreshaj - Procesverbalin e kemi përpara e ki edhe ti kryesues se a është cek që kemi diskutuar a jo, kur kemi diskutuar për piken e rendin të ditës këshilltari Nimanaj nuk është përfshirë fjalimi jemi dhe i Agronit se kanë përfshirë me qëllim për shkak se ju keni bërë shkelje zotëri Kryesues ku nuk e keni hedhur në votim propozimin e këshilltarit

Kryesuesi-Po pse nuk e propozoni qetash qatë pikë që e keni kërkuar në mbledhjen e kaluar.

Florin Dreshaj- Nuk po e propozoj

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka?

Hedh në miratim

Miratohet unanim

Konstatohet që me 25 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 27.02.2023 me vërejtje.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Istogut. A ka dikush diçka?

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi - përsëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Projekt Rregullores për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Istogut.

Niman Beqira - Faleminderit për fjalën Kryesues, përshëndetje për te gjithë te pranishmit unë kam një pyetje tek neni 20 deponit të mbeturinat do te thotë se deponimi i mbeturinave ne komunën e Istogut ne vareshmërin te karakteristikave te mbeturinave behet vetëm në deponit e licencuar dhe të lejuar përkatëse

pyetja jem është a ka deponi të linquesuar ne Komunën e Istogut, dhe deponia e Tuqepit a asht e linquesuar sepse nëse ajo nuk e është e linquesuar atëherë po i bien qe na po e shkelim këtë rregullore qe kemi me votuar sot, edhe pyetja tjetër është tek mbikëqyrja inspektimeve apo kundërvajtës këtu thotë pika 2 qe inspektori komunal për mjedis mbikëqyr dhe inspekon menaxhimin e mbeturinave te hapësirave qe gjenden ne territorin e komunës ton a kemi na inspektor komunal për mjedis, nëse nuk kemi këtu tash është pika 5 se komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis thotë puna detyra dhe përgjegjësit e tij I kryen zyrtari komunal I cili I kryen te gjitha detyrat dhe përgjegjësit e inspektorit komunal për mjedis pra pyetja jem është a ka zyrtar komunal dhe nëse ska atëherë cili zyrtar komunal e kryen detyrën e inspektorit komunal për mjedis sepse këtu po thotë zyrtari komunal dhe nuk pe cek se na kemi shumë zyrtar komunal kishte qen mirë me dit cili e ka at kompetencë që me inspektu dhe vendosjen e gjobave faleminderit.

Drejtori Abedin Kabashi- Faleminderit Niman po shkojmë me pyetjen e par qe e keni parashtruar për deponin ne Tuqep ajo është deponia transfer d.m.th. nuk asht e lincencuar për arsye se nuk i plotëson kushtet dhe jo vetum deponia jon po edhe shumë komuna tjera nuk kanë te lincensuar, te lincensuar janë deponit regjionale duke përfshire Regjionin e Pejës, Mitrovicës, dhe vendeve te tjera Prizrenit dhe kështu me radhe, ndërsa planin qe e kemi na si drejtori është që në të ardhmen që kjo deponi të transferohet dhe materiale e mbeturinave te kalojnë në Deponin e Pejës qe besoj së do të ndodh gjate këtij viti jemi duke punuar në atë drejtim që ajo të ndodh, ndërsa pyetjen qe e pate për zyrtarin për ambient na realisht jemi ne procedurë te konkursit për zyrtar edhe detyrën e zyrtarit ose e inspektorit e ambientit e ushtron Elfete Blakaj për momentin kjo është e gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush a ka te shtoj diçka rreth kësaj Rregullore te rëndësishëm. Pasi që nuk ka diskutime tjera.

Hedh në miratim

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

25 anëtar prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023 -2027.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, znj. Elian Blakaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Planit Strategjik për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore për komunën e Istogut 2023 -2027.

Florim Dreshaj - në materialin që e keni dërguar kam vërejtur se mungojnë disa kulla që janë restauruar tash më disa nga qeveritë e me hershme e disa nga organizatat të ndryshme e që nuk janë të përfshira të gjitha. A ka ndonjë arsyetim për ato pse nuk janë

përfshirë? P.sh në Vrellë Kulla e Sali Dreshaj nuk është e përfshirë është e restaurume është dashur edhe ajo të jetë në këtë listë, ka edhe disa tjera që nuk janë të përfshira a ka ndonjë arsyetim për ato?

Nimon Beqiraj- Faleminderit kryesues unë e kom një pyetje tek fotoja e 14 ku thotë Kisha Serbe e Shën Gjonit ne Cerkozë shekulli XIV pra qysh e dim na objektet fetare nuk kanë kombe as shtet na nuk kemi te drejtë me i vendos mbiemra Kishave, kishave na e dimë që është Kisha Ortodokse ose Krishtere por jo Kisha Serbe apo Shqiptare na ku do që shkojmë ne Xhami nuk themi që po shkojmë ne Xhami Shqiptare por po shkojmë ne Xhami te Besimit Islamë, gjithashtu sipas vendasve kjo Kisha është ndërtuar mbi themelet te një Kisha ma te vjetër pra mendoj se te quhet Kisha Ortodokse e Shën Gjonit ose termi i duhur mund te ishte Kisha Ortodokse, po ashtu e kam edhe një pyetje tek spot analiza që është çështja kyçja 1 përfshirja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në edukimin primar dhe sekondar tek përpirësit pika e 3 këtu shkruhet se ajo që shkruhet i ka humbur kuptimi asaj që në të vërtet kanë dashur për me shkruar, p.sh këtu thotë ka përkrahja institucionet komunale për integrim të trashëgimisë kulturore në edukim kjo nëse thuhet ka përkrahja ishte deshtë të jetë të mundësit po nëse thuhet ka përkrahje te institucioneve komunale për integrim te trashëgimisë kulturore atëherë kjo është vendosur keq dhe është e pavërtetë, pse po them që është e pavërtetë nga ana tjetër të dobësitë dhe rreziqet komplet flet për mungesën përkujdesen pika e 1, pika e 2 mungesa e vizitave te nxënësve të monumentet kulturore, pika 3 mungesa e literaturës se trashëgimisë kulturore, mungesa infrastrukturës, mungesa e narracionit, mungesa e buxhetit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mungesa e vullnetit politik për ndryshimin e programit edukative pra kjo mungesë e vullnetit politik për veç tanave e citoj për shkak se çfarë mundët me pas vullnet politik për mos me i shti ose mos me i përfshi ne trashëgimin kulturore meqenëse edhe ju numër i keni edhe na çdo here ju kemi përkrah se është një pik që nuk është deshtë për me hi këtu, prandaj kjo pika e 3 mundët me kanë një mundësi ne te ardhmen komuna me na përkrah për integrimin e trashëgimisë kulturore ne edukim faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit - Faleminderit i nderuar a dëshiron që të bëjmë si draft me i votuar, edhe unë jam pro asaj te pares.

Niman Beqiraj- Fillimisht të paren po e votojmë të ndarë, te dytën ta dëgjojmë çka po thotë drejtoresha se ne bazë te asaj që është shkruar këtu ne fakt edhe kjo duhet me ndryshuar faleminderit.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, znj. Eljan Blakaj - Se pari duhet me ju përgjigjur Florim Dreshaj sa i përket te objekteve dmth ajo listë që është vendos ne strategji është marr direkt prej Ministres Kulturës siç e kam theksuar në komitet për politik dhe financa Komuna e Istogut nuk ka e një listë të objekteve të trashëgimisë kulturore ajo listë është marr prej Ministres se Kulturës dmth ato objekte që janë për momentin nen mbrojtjen janë vendosur ne strategji, sa i përket asaj që e tha Nimani për analizën soft ajo është veç gabim teknik dmth është ajo siç e theksove, ndërsa sa i përket pjese tjetër është gjithçka ne rregull.

Florim Dreshaj- Faleminderit Kryesues pra drejtoresha e sqaroj se pse nuk jon a ka mundësi që komuna për me i shti ne listë nuk po kërkojmë për me shpenzuar për to veç me kanë një listë ose me kërkuar prej Ministres se Kulturës se ku shkojnë këto ato me u

fut në pjesën e trashëgimisë kulturore, fakt edhe janë trashëgim kulturore me kanë të përfshira të gjitha ka shume kulla në qoftë se nuk futen në mbrojtje ndoshta dikon e pengojnë dikon në oborr pak ka pengës doin me ndërtuar një shtëpi ose një oborr ose ndonjë diçka tjetër në qoftë se i dëmtojnë ato pse janë shpenzuar kogja do pare për me restaurua kush merret pak me to e din sa kushton restaurimi i një monumenti edhe ish kanë dom mos me qen të mbrojtur dhe mos me kanë të figuruara.

Niman Beqiraj - Atëherë unë pe vendosi kryesues që me qit në votim bashkërisht te dyjat bashke meqenëse edhe drejtorja ekzekutivi dhe ti kryesues po pajtohesh që këto duhet me ndryshuar mendoj e nuk ka arsyetim tjetër që mos me u hodh në formë të përbashkët në votim.

Nexhdet Ramaj - Përhëndetje për te gjithë, deshtëm me ditë a kemi të drejt me propozuar edhe na ndonjë objekt për shembull se janë disa objekte nuk janë të përfshira vetëm dua me ditë a kemi të drejt të propozojmë, në qofte se kemi te drejt atëherë kisha propozuar për Mejtepin pran Xhamisë ne Uçë, Mejtepi i Xhamisë i cili është përdor për mësim në vitet e mëhershëm, e nuk është i përfshirë mejtepi pranë Xhamisë ne Uçë.

Kryesuesi i Kuvendit - Këta sa e kam kuptuar kam qen në këtë dëgjim publik Nexhdet ka mjaft objekte kulla është e Bajraktarëve në Uçë që faktikisht tan e dimë historinë e tyre prej prindërve, gjyshërve tan shumë e lavdishme, edhe e prekshme i kanë përmendur kullat e tyre por shumë familje kullat ndërkohë që tha edhe Nimani dhe Florimi i kanë prishur kullat shkaku i jetës që ka rrjedh pastaj edhe ato kulla edhe nuk janë ose në themelet e tyre janë ngritur diçka tjetër faktikisht është problem kjo strategji.

Nexhdet Ramaj- E ceka mejtepin pasi kjo është përdorur për mësim shqip para se me u hap shkollat në gjuhën shqipe është përdor edhe është e karakterit historik besoj veç për atë.

Hajrush Shoshi- Përhëndetje Kryesues, Nënkryetar, Drejtor, Asamblistët dhe te gjithë te pranishëm dua te ceku se te plani i veprimit e kemi identifikimin i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Komunën e Istogut dmth kjo punë vazhdon dhe ja te ndara mjetet te parapara dikund 35 mijë euro sa do te realizohet kjo mirëpo kjo mbetet detyrë e institucioneve sepse na nuk mund te propozojmë këto objekte të trashëgimisë kulturore si janë komisionet të cilat vendosin se cili objekt do ti takoj ose jo trashëgimisë kërkesat nuk ndalen as një here nëse ka dikush kërkesa sigurisht mund ti dërgoj në drejtorin përkatëse edhe janë komisionet. Është e mirë që para nesh e kemi edhe një listë me emrat e objekteve të trashëgimisë kulturore prandaj kjo listë gjithmonë ka vend që të pasurohet ka vend që të punohet me shumë. Është mirë që këto objekte se paku shumë shpejt të vendosen nga një pllakë në secilin objekt që është në mbrojtje të trashëgimisë kulturore edhe pse ka qen pare edhe tabela të cilat janë të vendosura në drejtim se ku janë objektet e trashëgimisë.

Drejtoresha e Kulturës, Rini dhe Sport, znj. Elian Blakaj – nga fillimi e kam theksuar se nuk është në rregull me u vendo një listë e cila vjen nga Ministria së Kulturës. Për deri sa ne si komunë nuk kemi pasur një listë kjo strategji është bere me i identifikuar të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore siç e than edhe disa nga këshilltaret kjo strategji është që të identifikohen objektet kulturore që nuk janë të përfshirë.

Florin Dreshaj – kam një pyetje këto varrezat e dëshmorëve dhe lapidaret që po ngritën a duhet edhe këto me hy në trashëgimi kulturore?

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka,
hedh në votim propozimet e Nimanit
Miratohet unanim

**Hedh në votim komplet strategjinë
Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit
Të pranishëm 26 anëtar të Kuvendit të Komunës**

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2022, edhe këtë rregullore e keni pasur dhe keni mundur ta shikoni nëse ka dikush diçka rreth saj urdhëroni?

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, znj. Elian Blakaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Raportit vjetor të punës të NP. "Ambienti" për vitin 2022.

Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një pyetje rreth tarifave a mund të na shpjegoni sa janë tarifat a janë fikse për faturat e mbeturinave, kategoria e bizneseve sa është tarifa e fshatrave e zonave, si janë faturat sepse ne e kemi votuar një ndryshim të faturave para dy muajsh dhe për afërsisht dua ta di si janë faturat sepse në janar i ka ardhur ndryshe dhe në shkurt ndryshe.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, znj. Elian Blakaj – në shtator është ber ngritja e faturave vetëm për amvisëri nga 5 euro në 6 euro. Ndërsa për biznese nuk ka pasur ngritje, në biznese nuk ka ndryshime të çmimeve. Vetëm se ka pasur barazim brenda kategorive. Ka ndodhur nivelizimi brenda kategorive kemi pasur kategori të njëjtë por jo me të njëjtën tarifë tani i kemi bërë kategoritë e njëjta me të njëjtën kategori siç janë të gjitha bizneset.

Niman Beqiraj – ne kemi votuar për ngritjen e tarifës në shtator nëse nuk gaboju, kur ka hy ajo në fuqi, se nëse ka hy ajo në tetor nëntor ose dhjetor nuk ka ndonjë far ndryshimi, se raportet janë të njëjta si muajt paraprak nuk ka ndonjë dallim, kam edhe një pyetje këtu thotë 46 mijë e 219euro ka qen fitimi këtu po e përfshi edhe at huazimin që ja kini jep Pejës 14 mijë euro, nëse çdo vite kemi mundësi ne që të realizojmë fitime e pagesat e Istogut me ja jep Pejës atëherë këtu duhet me e bere një ndryshim ose duhet të jetë komplet kompania në menaxhim të Istogut ose duhet të kthehet tarifa e vjetër. E kam edhe një pyetje tjetër çka nënkuptoni me shpenzimet e reprezentacionit dhe çka hynë saktësisht të shpenzimet e përmbaruesit. Kujt i kini pasur borxh qe ju ka quar të përmbaruesi edhe kam një pyetje tek sektori i operatives një pjesë e madhe e fshatrave nuk kanë as kontejner. Tek raporti i punës thotë që shtat ditë në javë ka bërë mbledhjen e mbeturinave ndërkaq ne Banjë e mirëmbajnë dy dit me punëtor të rregullt dy here në javë, ndërkaq në Vrellë thuhet që është një punëtor që vjen një here në javë ndërkaq e

dyta nuk specifikohet thuhet sipas nevojës. Kam edhe një pyetje është krekës nga banoret të memoriali në Vrellë aty ka vizitor të shumta por nuk kanë ku me i hedh mbeturinat nuk ka kontejneri aty as ata që janë me të vegjël e as kontejneri të medhenjë.

Menaxheri i NPL Ambienti, z . Alferd Tahirsylaj – faturat me u rrit ja kanë filluar nga janari i vitit 2023, në shkurt është fatura e janarit me rritje. Çështja e përmbaruesit janë lëndët që ne i kemi dërguar qytetaret që nuk kanë paguar borxhin. Të memoriali në Vrellë qytetaret aty afër nuk kanë dashur që të len kontejneri aty. Reputacioni kanë qen dy pensionime që i kemi organizuar në shenjë falënderimi për punën dhe kontributin e tyre një drekë për punëtoret.

Niman Beqiraj – mbete edhe dy pyetje pa u përgjigjur punëtori në Vrellë. Edhe reputacion mbi 2000 € dy dreka?

Menaxheri i NPL Ambienti, z . Alferd Tahirsylaj - janë 40 punëtor tash llogarite vetë. Në Vrellë është një here në javë dhe është duke ndodhur dhe i dyti sipas nevoje.

Haki Podrimaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam parë punën e ambientit të vitit 2022. Unë do të ndalna të shpenzimet për punën që e kanë bërë shumë mirë janë duke punuar e kanë obligim me ju përshtat edhe qytetarëve. Shpenzimet po me duken pak të mëdha.

Menaxheri i NPL Ambienti, z . Alferd Tahirsylaj - sqaron shpenzimet e bëra, rritja e çmimeve sidomos të nafta.

Florin Dreshaj – ambienti çdo ditë po behet me i pasur, sa i përket raportit ka shumë paqartësi i mbete borxh edhe Nimanit e përmendi shumen mbi 46 mijë euro kanë qen fitim me ato që ju keni jep komunave tjera borxh pastaj mbi 3mijë euro përmbarues që po i bën dikund mbi 50 mijë euro fitim edhe të ajo tarifa qenë LVV kemi qen kundër kësaj ngritje 6 euro, ndoshta është me e arsyeshme e kthyer prapa në 5 euro siç ka qenë sa ju përket automjeteve aty thuhet që janë për momentin 12 automjete një traktor në shfrytëzim nëse po e kuptoj drejt nuk është i kompanisë por e keni marr dikund me qira ose ndonjë formë tjetër edhe një mercedes kiper edhe aj në shfrytëzim edhe e ka gjendjen e keqe nëse ka gjendjen e keqe a ka një marrëveshje që mundeni me kthyer që mos me e mbajt me në shfrytëzim apo është diçka tjetër. Shumë çka u përmend nuk dua të përsëritëm vajrat po me duken që janë shumë shtrenjte.

Kam edhe një pyetje të deponit ilegale janë duke u shtuar mbi fshatin Vrellë është një pamje shumë e shëmtuar a keni mundësin këtu me bë diçka dhe kërkesat e fundit është që raportet tjera me qen me të qarta. 6 shoferë 12 automjete si i vozitin ata këto ?

Menaxheri i NPL Ambienti, z . Alferd Tahirsylaj - traktori dhe kamioni që i përmende janë të komunës, traktori nuk vozitet përditë as ky kamion nuk punon përditë, 6 shoferë janë përditë në teren vetëm kur kemi nevojë, deponit ilegale janë kompetent e komunës. Te vajrat janë të ndar vajrat për pjese përkatëse. Tarifa në 5 euro nuk mund të kthehet sepse na mbesin punëtoret pa paga.

Faruk Kabashi – këto 14 mijë euro mos me i shti të shpenzimet pasi që shpenzime nuk janë çmimi është shtrenjtuar për ekonomit familjare për 20% se po thuhet ju kryesues nuk është shtrenjtuar shumë.

Ajshe Metaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, vetët Ambienti e bëjnë një punë të shkëlqyer ne i përgëzojmë në këtë drejtim por çështja ose fokusi ishte të shpenzimet që kemi diskutuar shumë here deshta me u ndalur të ato 14mijë euri siç u ndalen edhe shumë koleg u pa edhe shkëputja nga Peja mirë po a duhet ne që fillimisht se sa zgjasin ato procedura të pavarësismit a duhet që të përshpejtojmë ne në mbledhjen e borxhit apo huas se ne ja kemi dhen apo sikur ne të shkëputemi e ata të hidhërohen e mos ti kthejnë ato para edhe është një mungesë p.sh që ne Komuna e Istogut përfaqësues në bord, si do të mbrohen interesat tona?

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diçka?

Pasi që diskutime tjera nuk ka kalojmë piken tjetër

Konstatohet që 24 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Themelimi i komisionit për kshillat e fshatrave, sqaron komisionin dhe përberjen që duhet të jetë në këtë komision.

1. Melis Smakic nga komiteti jo shumic,
2. Valbone Demaj, LDK
3. Ardita Idrizaj, AAK
4. Floriana Maxharraj, LVV
5. Drejtori i administrates nga egzekutivi i cili do të jet edhe kryesues i komisionit
6. Një anëtar nga shoqeria civile,
7. Një përfaqësues nga këshilli i atijë fshati.

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që 23 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Hajrush Shoshi – i kam dy pyetje: kam një krekes nga shumë biznese që dita e diel të jetë ditë pushimi ne e kemi aprovuar një rregullore mbi orarin e punës, prandaj nëse ka diçka mangësi ish dashur që ekzekutivi ta plotësoj atë Rregullore të Kuvendit të Komunës.

Ndërtimi i sheshit “Ibrahim Rugova” të gjithë mëzi e kemi pritur por ndalimi i qarkullimit të veturave aty ka rezultuar me mbylljen e shume lokaleve afariste aty, po këtu shumë lokale afariste janë mbyllur ne besoj që duhet të ju ndihmojmë bizneseve të ju ndihmojmë qytetarë dhe të shikohet edhe një here, të diskutohet me ato biznese se cila është dashur të jetë zgjedhja me e mirë nëse janë sot 5 ose 6 lokale të mbyllura për mu

nuk është një mesazh i mirë. Këto dy çështje kisha dashur që ekzekutivi të merret me to dhe ti bien vendimet e duhura.

Nimon Beqiraj - unë i kam 4 pyetje që vijën nga ankesat e qytetareve dy nga dy prindër dhe dy tjera të qytetarëve të zakonshëm.

Ankesa e parë është nga prindërit për shkollën fillore „Bajram Curri” në Istog ankesa ka të bëjë me shëndetin e nxënësve si pasojë e mykut, vlagës, lagështisë dhe të ftohtit nga ku e kemi vizituar kemi dëshmi edhe foto së është ashtu ndërsa gjatë bisedave me mësimdhënësin aty pik çatia një shi sa do i vogël nuk ka kushte për mësim ose duhet me e ndërruar klasën ose duhet me i bërë dy klasa bashkë kjo është dashur që të paktën të merret parasysh.

Ankesa e dytë edhe kjo është për të tretën here po ashtu për shkollën „Bajram Curri” në Istog për mos lejimin e shfrytëzimit të sallës së edukatës fizike. Pra me shqetësim të madh prindërit thonë se gjatë orës së edukatës fizike nxënësit në sallë nuk lejohen ndërsa nuk lejohen as të qëndrojnë brenda, nxënësit në ditë të ftohta qëndrojnë jashtë neper oborr. Shkolla fillore „Bajram Curri” me këto kushte mua me shkumë me ngjan në ndonjë shkollë ushtarake që të mësohen me kushtet të tilla. Ndërkaq gjatë bisedave me mësimdhënësin ata ankohen se salla nxinet nga profesor që mbajnë kurse me pagesë nga ku përfitojnë në dëm të nxënësve. Faturën e rrymës me shuma të mëdha obligohet shkolla me i paguar, mbaj kurse private bën shpenzime e paguaj shkolla. E nxënësit e asaj shkolle mos e shfrytëzo.

Pyetja tjetër punimet e dobëta që janë duke ndodhur kudo e sidomos në varrezat e reja në fshatin Vrellë pra banoret ankohen se shtyllat e betonit nga nderimet e me hershme që kanë qenë aty nuk janë larguar veç janë gropos e që janë shumë të rënda sepse janë beton nëse ne dojmë që nesër me e hap një varr të ri, pa hilt nuk besoj që mund të hapim aty, varrezat kanë marr formën e lugut ekziston mundësia që shiu ti marr varrezat pastaj, edhe rrethoja me beton ka themel centimetrash e qysh tani shiu ka depërtuar dhe ja ka gërryer themelin.

Pyetja katërt: salla e sportit në Vrellë është investim që po shkon dëm pra një gërmadhë e rrezikshme drejt shkatërrimit. Një pallat i rinis se është kthyer në një kërcënim për rinia, ku tani përdoret si vend strehim për narkoman e drogirash këtu po rrezikohet rinia, kur kanë në plan me filluar me punë ose me e bërë pagesën që e ka në detyrim komuna në mënyrë që pastaj me vazhduar punimet me atë sallë.

Arta Balaj - kam pyetje për z. Naim Belulaj, disa fëmijë me nevoja të veçanta neper çerdhe kanë nevojë për mësues ndihmës, kur do të ketë logoped nëpër çerdhet e qytetit të Istogut duke e parë nevojën e madhe që fëmijët kanë.

Floriana Maxharraj - përsëndet të gjithë të pranishmit, me datë 26 qershor 2019 është vendosur gur themeli i çerdhes së re në Istog projekt i financuar nga ministria e Arsimit në vlerë di kund rreth 670mijë euro. Për shkak të kapaciteteve të pakta që ka komuna jonë dhe kërkesës së madhe për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe pyetja ime për ju është deri ku kanë arritur punimet, për çfarë arsye janë ndalur dhe kur pritet të hy në funksion.

Ajshe Metaj - kam pyetjen për orarin e punës siç e beri edhe Hajrushu, ne e kemi miratuar një Rregullore këtu por për arsye të ndryshme nuk eci kjo far pune. Por ditën e diel kudo është ditë pushimi, nëse nuk ka vështësi rreth monitorimit të orarit, në çoftë se mungon inspektori i punës.

Në mandatin e kaluar e kemi pas propozuar në kuvend hapjen e inkubatorit të biznesit në shtëpinë e kulturës por as këtu nuk lëvizi gjë d.m.th sa janë gjasat me u aktivizuar inkubatori i biznesit duke marr para sysh se është i nevojshëm i domosdoshëm edhe për zhvillim ekonomik të komunës edhe ka përfitime mirë po mbi të gjitha aty zënin vend dy ose 3 punëtor hapeshin vende pune kjo nuk ka lëvizur fare d.m.th sa ka mundësi ekzekutivi me e qu me përpara këtë çështje apo do anulohet krejt.

Florin Dreshaj – pyetja ime është për drejtoreshën Blakaj , ka të bej me zgjedhjen e hembollistes me të mirë të vitit ku është zgjedhur hembollistia nga Brazili, kjo vjen nga shqetësimi që e kanë shprehur disa sportist vendas, dua ta di në bazë të së cilave kritere është zgjedhur ajo sepse ka sportist që janë ndier të ofenduar për kontributin dhe mundin që e kanë dhen se hembolli me qen aty ku sot është e që krenohemi të gjithë me ta edhe shumë ndihen të ofenduar që nuk është vlerësuar puna dhe mudi i tyre.

Negjdet Ramaj – ka pyetje për drejtoreshën për mirëqenie sociale, dihet që kemi pasur dëme të mëdha në Istog nga erërat e forta që kanë ndodhur në fillim të muajit shkurt po ndalna të banesa kolektive të parku këtu në qendër e cila është dëmtuar në çati dhe nuk është intervenuar ende deri me sot koha ka qen e mirë dhe ka pasur mundësi të angazhohet një punëtor dhe ti vendos tjegullat pasi që ato nuk janë dëmtuar vetem se janë larguar pasi që nga sot do të ketë reshje shiu e behet me keq, ka mundur të intervenohet e mos të prishet tenderi.

Lavdije Bujupaj – kam një propozim sot kishim mbledhjen e Komitetit për komunitete dhe aty kemi pasur në rend dite Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave dhe propozoj që në të ardhmen nuk e di saktë a ka mundësi të jetë prezent drejtori përkatës se paku me laburuar temën në fjalë në mënyrë që debati të jetë me i favorshëm. Propozoj që në të ardhmen të jen prezent drejtoritë përkatës për temat që janë aty.

Kryesuesi i Kuvendit – komiteti duhet me i ftuar drejtoritë përkatës me ftesë.

Nënkryetari i Komunës – dy kërkesa që i parashtrij Hajrushu 1. çështja e orarit të punës me bizneset ka filluar një diskutim dhe ekzekutivi është duke u marr me atë punë që të respektohet kjo dhe të jetë dita e diel pushim.

Sa i përket sheshit Ibrahim Rugova me sa kam informata shesh tjetër nuk kemi për momentin dhe në këtë kohë do vazhdoj të jetë i mbyllur do shohim në vazhdim si do të jetë. Jemi duke u marr me rrugë alternative në mënyrë që të kemi qasje dhe lëvizje edhe për biznese. Çështja e inkubatorit edhe me atë punë jemi duke u merr po besoj se shumë shpejt do ta funksionalizojmë inkubatorin të biznesit.

Naim Behlulaj – Niman është e vërtet se çatia në shkollën „Bajram Curri” pikë ne kemi pasur një marrëveshje me ministrin e arsimit ku është dal në tender rregullimi i çatis mirë po për shkaqe teknike është anuluar, shpresojmë së shumë shpejt do të rregullohet çatia prap me ndihmën e ministrit, janë në katin e II janë dy klasë qe pik kanë intervenuar ekipi i shkollës është ber një pastrim të cilat i kemi kaluar në objektin e vjetër se janë pasdite dhe ka hapsir të mjaftueshme mirë po nuk kanë pranuar prindërit kanë kërkuar me i bë një klasë e kemi ber improvizim dhe janë aty. Sa i përket sallës edukatës fizike ju kam thënë se do marr masa kam lëshuar një vendim dhe kam vizituar personalisht dhe i kam par se orët e edukatës fizike mbahen në sallë por janë tre arsimtar të edukatës fizike dhe është e pamundur që të marrin pjesë në të njëjtën kohë

tret. Sa i përket sallës në Vrellë ju e dini që është kontrata nga komuna por financimi nga ministria e kulturës kemi kërkuar me e vazhduar punën por punë kryesi ka kërkuar nga ministria dhe nga ne që me e bërë një përkrahim me ndryshim të pozicioneve që e kap vlerën dikund afër 100 mijë euro e që ne nuk i kemi mundësit me i bë ato mjete ministria nuk po përgjigjet dhe kjo është ajo që ka mbetur salla deri me tani.

Arta asistentë i kemi dërguar neper kopshte ku ka pasur nevojë ndërsa për logoped nuk mund të premtoj arsyeja është sepse kemi pasur një marrëveshje me një universitet i cili është dashur me e marr aprovimin e kuvendit ku ministria nuk e ka aprovuar dhe komuna ka mbetur pa logoped. Çerdhja e re në Istog është i njëjti rast si palestra në Vrellë.

Abedin Kabashi – Niman për varrezat në fshatin Vrellë faza e parë ka përfunduar, prej shirave nuk ka qen andej dhe nuk e di gjendjen momentale. Hapja e varrezave nuk ka mundësi me u përpjek me betone.

Për dëmtimin e çatis se banesave kolektive nuk kemi kontratë për këto punë vetëm për ndihmë emergjent por nëse ka gatshmeri nga banoret me krye punën vet ne materialin ja kemi jep. E kemi rastin edhe ne qendër ashtu vet e kanë rregulluar as materialin nuk e kanë pranuar nga komuna por e kanë blerë vet një qytetar Fejak.

Eljan Blakaj – mënyra e zgjedhjes së sportistit të vitit, klubet kanë ber propozimet e tyre ku kanë pasur afat një javë me i dërguar propozimet për sportistin e vitit bashkangjitur me sukseset, ndërsa vlerësimi është bere nga komisioni i përberë nga arsimtaret e edukatës fizike, nuk ka qen komisioni komunal. Komisionin e falënderoj sepse kanë bere një punë të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka?

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i mbledhjes,
Enver Rugova

